

Nr 316A prot
15 ou 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 581/4 Prot.

Fier, më 10.04.2022

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 22, dhe Nr. 23, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 29.03.2022.

BASHKISË ROSKOVEC

KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 2607/2 prot. datë 08.04.2022, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 361/2 prot. datë 11.04.2022 pasi u njohëm me informacionin dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar nga ana jonë me shkresën Nr. 361/1 datë 05.04.2022 për vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 22 dhe 23 datë 29.03.2022.

Prefekti i Qarkut Fier, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8, shkronja "a", neni 16 si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen datës 29.03.2022, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 3, datë 29.03.2022, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 547, prot. datë 25.01.2022, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehet si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 22, datë 29.03.2022, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2023-2025", shoqëruar nga projekt-vendimi Nr. 22, datë 23.03.2022, protokolluar me Nr. 2372 prot. datë 23.03.2022, relacioni shpjegues Nr. 2372/1 prot. datë 23.03.2022, Është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nënpika 1.1, shkronja "b", neni 41, pika 1, ligjin Nr. 68/2017, "Për Financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34, pika 6, ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" (i ndryshuar) neni 3, neni 26, neni 32, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar), si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025", Kap. I, pika 4.

Sjellim në vëmendjen tuaj se në bazë të ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34 pika 6, dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025 kap. I, pika 4,

afati për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programeve të PBA 2023-2025 është jo më vonë se data 15 mars 2022. Mbetet nën përgjegjësin tuaj zbatimin e këtij afati ligjor.

Vendimi i Këshilit të Bashkisë Roskovec Nr. 23, datë 29.03.2022, “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022” është dërguar i shoqëruar nga projekt vendimi Nr. 23, datë 23.03.2022, protokolluar me Nr. 2373 prot. datë 23.03.2022, relacioni Nr. 2373/1 prot. datë 23.03.2022, dhe relacioni Nr. 2373/2 prot. datë 23.03.2022.

Ky vendim ka miratuar një rishpërndarje fondesh me qëllim financimin e vendosjes së dy statujave në territorin e Bashkisë Roskovec. Fondi për këtë financim është marrë nga programi 09120 dhe një pjesë nga fondi rezervë. Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (i ndryshuar) neni 6, paragrafi 3 përcakton se *Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.* Të njëjtën llogjikë ndjek edhe udhëzimi Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” në pikën 132, e cila përcakton se *“Fondi rezervë është fondi që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit”,* pra, vendimi në dispozitivin e tij vendos për përdorimin e fondit rezervë në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar.

Në relacionin që shoqëron vendimin thuhet qartë që ky shpenzim ishte i parashikuar edhe në buxhetin e vitit 2021 por për arsye të ndryshme nuk është realizuar. Sipas relacionit këto arsye qëndronin edhe në vitin 2022 dhe për këtë shkak nuk u parashikua në buxhetin e vitit 2022. Kjo tregon se kemi të bëjmë me një shpenzim të njohur nga Bashkia Roskovec prandaj në këtë rast nuk duhet përdorur fondi rezervë, por bashkia duhet të gjejë mjete të tjera ligjore për të financuar këtë shpenzim.

Për sa më sipër, vendimi Nr. 23, datë 29.03.2022, ju kthehet pasi bie në kundërshtim me ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (i ndryshuar) neni 6, paragrafi 3, dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 132.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

PREFEKTI
Lefter Shehaj

